



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 nr 351-242 SP/20
Date 27.08.2020

KONTRATA PUBLIKE nr. 051/2020

, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; Nr Biznesi 07000032, Nr Fiskal 600219366 , qe perfaqesohet nga Menaxheri i Prokurimit z. Abaz Foniqi

dhe

LIMIT L –B SHPK, Nga PRIZRENI me seli ne PRIZREN Komuna PRIZREN , Nr. Biznesi numer Fiskal 810593617 , qe perfaqesohet nga pronari z. SUADA ASLLANI

ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për PUNET në vijim:

RENOVIMWE NE AMF NE DRENOVC DHE SHTUPEL

me numër identifikues: **634-20-3225-5-2-1/INT.634-20-47-521**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet per njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e PUNEVE-SHERBIMEVE në vijim:

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	Hapja e punishtes, vendosja e stafit në punishte, organizimi, vendosja e shenjave paralajmëruese për punishte dhe rregullimi sipas normave teknike.	59.00	1.00	TOTAL	59.00
2	Demontimi i dritareve nga druri në pjesën e objektit ekzistues me dimensione 80x90 ; 120x140 ; 210x150 ;	3.54	3.00	COPE	10.62
3	Demontimi i dyerve nga druri në pjesën e objektit ekzistues me dimensione 0.90x2.40m; 0.70x2.00 m ; 0.90x2.00 m	4.72	4.00	COPE	18.88
4	Debllokimi si dhe funksionalizimi i WC-së ekzistuese , në llogari të futet dhe ndërrimi i gypave kokave kolektoreve, fontanave dhe elementeve tjera për funksionim.	236.00	1.00	COPE	236.00
5	Debllokimi si dhe funksionalizimi i oxhakut ekzistuese, në llogari të futet dhe ndërrimi i gypave nëse shihet e nevojshme si dhe rregullimi i disa tjegullave në kulem izolimi dhe olluket et e reja.	41.30	1.00	COPE	41.30
6	Debllokimi si dhe funksionalizimi i oxhakut ekzistuese, në llogari të futet dhe ndërrimi i gypave nëse shihet e nevojshme si dhe rregullimi i disa tjegullave në kulem izolimi dhe olluket et e reja.	1.18	70.00	M2	82.60
7	Demolimi i qeramikave ekzistuese në dhoma dhe pjesën tek dera hyrëse, gërryerja dhe pastrimi i nevojshëm.	1.06	23.00	M2	24.43

8	Furnizimi dhe montimi i qeramikës në dhoma sipas projektit, dimensionet dhe ngjyra të caktuara nga organi mbikqyrës. Si dhe ngjitja vertikale 5cm në mure .	16.52	70.00	M2	1,156.40
9	Furnizimi dhe montimi i qeramikës në shkallët e jashtme tek dera hyrëse, dimensionet dhe ngjyra të caktuara nga organi mbikqyrës. Qeramikat të jenë për ambient të jashtëm me ngjitës adekuat, në llogari të hyjë ngjitësi dhe fugat.	17.70	20.00	M2	354.00
10	Furnizimi, transporti dhe lyerja e sipërfaqeve të mureve të brendshme dhe tavanit me glet dhe ngjyrë polikollor, në llogari të hyjë edhe riparimi i pjesëve të dëmtuara, riparimi me rrjetë i këndeve të dëmtuara, plasaritjeve dhe këndëve të shtyllave si dhe rreth dyerve dhe dritareve. Në llogari hyn komplet muret e brendshme të objektit.	1.18	450.00	M2	531.00
11	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës së hymjes nga PVC me dimensione 90 240 cm në objektin ekzistuese.	153.40	1.00	COPE	153.40
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyreve nga PVC me dimensione 90 205 cm në objektin ekzistuese.	123.90	2.00	COPE	247.80
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyreve nga PVC me dimensione 70 205 cm në objektin ekzistuese.	123.90	1.00	COPE	123.90
14	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC me dimensione 120 140 cm në objektin ekzistuese.	135.70	1.00	COPE	135.70

15	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC me dimensione 210 150 ; 80 90 cm në objektin ekzistuese.	159.30	2.00	COPE	318.60
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës nga hekuri me dimensione 4.50 x 150 cm në oborrin,objektit ekzistuese. Parashihet dhe dera për këmbësorë me dimensione 1.00x1.50	271.40	1.00	COPE	271.40
17	Rrafshimi i terrenit dhe punimi i hapësirës për trotuar më gjerësi 1,50cm dhe l ngritur 5cm nga niveli i rruges më kubëza betoni më lartesi 8cm duke përfshirë dhe shtrësen e zhavorit të përzier dhe kufizimin me skajore.	11.80	35.00	M2	413.00
18	Furnizimi,transporti dhe montimi i një lavaboe dhe l një rubineti si dhe montimi i një bojleri të vogël dhe funksionalizimi i tyre si dhe montimi i elementeve percjellese gypat, kokat dhe elementet tjera.	141.60	2.00	COPE	283.20
19	Furnizimi dhe montimi i 6 trupave ndriques LED në disa vende të nevojshme në çmim përfshihet furnizimi me kabull adekuat dhe kyqja në rrjetin elektrik,paisja me ndërpreresit adekuat si dhe montimin 10 prizave 6 ndërperseve,siguresave automatike,si dhe material i imet lidhes dhe montues i pa specifikuar.	29.50	1.00	TOTAL	29.50
20	Furnizimi,transporti dhe montimi i roletave në dritare.	21.24	1.00	COPE	21.24
21	Furnizimi,transporti dhe montimi i kablllove në disa vende sipas nevojës.	1.18	20.00	M	23.60
22	Furnizimi montimi i llogos sipas projektit	59.00	1.00	COPE	59.00

23	Furnizimi, transporti dhe punimi me kolir i coklles, me lartësi h=40cm në gjatësi të caktuar. Ngjyra dhe lloji i caktuar nga organi mbikqyrës.	5.90	25.00	M	147.50
24	Furnizimi dhe punimi i rrethojës metalike për rreth objektit sipas përshkrimit në vazhdim furnizimi me shtylla metalike me prerje terthore 80x80x3mm me lartësi 2m mbi tokë dhe të shtanguara në tokë 100cm në beton në gropat e hapura me pare, distanca ndërmjet shtyllave 2m-2.5m shtyllat duhet të mbyllën në pjesën e sipërme me kapak plastike për mbrojtje nga ujërat, furnizimi dhe punimi i shtangimeve horizontale me profile metalike 50x50x2mm, distanca ndërmjet tyre 2.5m, furnizimi dhe montimi i rrjetës metalike me ngjyrë të gjelbert në tërë sipërfaqen e rrethojës 20x2m, në qmim përfshihet edhe punimi i derës metalike në hyrje 4.0x2.0m gjithashtu përfshihet edhe lyerja me ngjyrë baze dhe ngjyrë metalike e të gjitha profileve metalike si dhe e rrjetës metalike me ngjyrë të gjelbertë, llogaritja bëhet në m2.	21.24	40.00	M2	849.60
25	Furnizimi dhe montimi me llamarin në kulem me gjitha elementet tjera përcjellëse si bulonat përfundim të tyre	10.15	55.00	M2	558.14
26	Hapja e punishtës, vendosja e stafit në punishtë, organizimi, vendosja e shenjave paralajmëruese për punishtë dhe rregullimi sipas normave teknike.	23.60	1.00	TOTAL	23.60
27	Demontimi i dritareve nga druri në pjesën e objektit ekzistues me dimensione 140x120 ; 130x130 ; 1.70x100 ; 1.90x100 ; 1.90x160	3.54	10.00	COPE	35.40
28	Demontimi i dyerve nga druri në pjesën e objektit ekzistues me dimensione 1.40x2.20m; 0.90x2.00 m ; 0.80x2.00 m	3.54	10.00	COPE	35.40
29	Debllokimi si dhe funksionalizimi i WC-së ekzistuese , në llogari të futet dhe ndërrimi i gypave kokave kolektoreve, fontanave dhe elementeve tjera për funksionim.	23.60	2.00	COPE	47.20

30	Debllokimi si dhe funksionalizimi i oxhakut ekzistuese, në llogari të futet dhe ndërimi i gypave nëse shihet e nevojshme si dhe rregullimi i disa tjegullave në kulem izolimi dhe olluket et e reja.	35.40	1.00	COPE	35.40
31	Demolimi i qeramikave ekzistuese në dhoma dhe pjesën tek dera hyrëse, gërryerja dhe pastrimi i nevojshëm.	1.18	120.00	M2	141.60
32	Pastrimi i oborrit në drejtim të objektit, largimi i dheut, demolimi i betonit ekzistues.	1.18	35.00	M2	41.30
33	Furnizimi dhe montimi i qeramikës në dhoma sipas projektit, dimensionet dhe ngjyra të caktuara nga organi mbikqyrës. Si dhe ngjitja vertikale 5cm në mure .	16.52	120.00	M2	1,982.40
34	Furnizimi dhe montimi i qeramikës në shkallët e jashtme tek dera hyrëse, dimensionet dhe ngjyra të caktuara nga organi mbikqyrës. Qeramikat të jenë për ambient të jashtëm me ngjitës adekuat, në llogari të hyjë ngjitësi dhe fugat.	16.52	25.00	M2	413.00
35	Furnizimi, transporti dhe lyerja e sipërfaqeve të mureve të brendshme dhe tavanit me glet dhe ngjyrë polikollor, në llogari të hyjë edhe riparimi i pjesëve të dëmtuara, riparimi me rrjetë i këndeve të dëmtuara, plasaritjeve dhe këndëve të shtyllave si dhe rreth dyerve dhe dritareve. Në llogari hyn komplet muret e brendshme të objektit. Kjo sipërfaqe përfshin edhe sipërfaqen e parashikuar në AMF Jashanice.	1.18	1,000.00	M2	1,180.00
36	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës së hymjes nga PVC me dimensione 140 220 cm në objektin ekzistues.	200.60	1.00	COPE	200.60

37	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyreve nga PVC me dimensione 90 205 cm në objektin ekzistuese.	123.90	7.00	COPE	867.30
38	Furnizimi, transporti dhe montimi i dyreve nga PVC me dimensione 80 205 cm në objektin ekzistuese.	123.90	2.00	COPE	247.80
39	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC me dimensione 140 120 cm në objektin ekzistuese.	159.30	6.00	COPE	955.80
40	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritareve nga PVC me dimensione 130 130 ;70 70 ; 90 100 ; 90 160 cm në objektin ekzistuese.	129.80	4.00	COPE	519.20
41	Furnizimi, transporti dhe montimi i derës nga hekuri me dimensione 4.50 x 150 cm në oborrin,objektit ekzistuese. Parashihet dhe dera për këmbësorë me dimensione 1.00x1.50	259.60	1.00	COPE	259.60
42	Rrafshimi i terrenit dhe punimi i hapësirës për trotuar më gjerësi 1,50cm dhe l ngritur 5cm nga niveli i rruges më kubëza betoni më lartësi 8cm duke përfshirë dhe shtrësen e zhavorit të përzier dhe kufizimin me skajore.	12.98	35.00	M2	454.30
43	Furnizimi,transporti dhe montimi i dy lavabovë dhe l dy rubineteve si dhe montimi i dy bojlerve vogël dhe funksionalizimi i tyre si dhe montimi i elementeve percjellese gypat, kokat dhe elementet tjera.	118.00	2.00	COPE	236.00

44	Furnizimi dhe montimi i 6 trupave ndriqes LED në disa vende të nevojshme në çmim përfshihet furnizimi me kabull adekuate dhe kyqja në rrejetin elektrik, paisja me ndërprerësit adekuat si dhe montimin 10 prizave 6 ndërperseve, siguresave automatike, si dhe material i imet lidhes dhe montues i pa specifikuar	177.00	1.00	KOMPET	177.00
45	Furnizimi, transporti dhe montimi i roletave në dritare.	16.52	10.00	COPE	165.20
46	Furnizimi, transporti dhe montimi i kablove në disa vende sipas nevojës.	1.18	20.00	M1	23.60
47	Furnizimi montimi i llogos sipas projektit	47.20	1.00	COPE	47.20
48	Furnizimi, transporti dhe punimi me kolir i cokles, me lartësi h=40cm në gjatësi të caktuar. Ngjyra dhe lloji i caktuar nga organi mbikqyrës.	4.72	25.00	M	118.00
49	Furnizimi, transporti dhe montimi i lëshesave gypa Ø600mm, në llogari të merret cmim njësi për gërmim të dheut për montim, vendosje e gypave, vendosja e rërës, mbulimi me zhavor dhe ngjeshja në nivel të duhur. Llogaria për metër gjatësi të lëshesës.	11.80	10.00	M	118.00

1.2. Vlera Totale e Kontrates me TVSH dhe taksa tjera është 14.474,71€

(katernbdgjetmijekaterqindeshatedhjetekatereuroe71/100)

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë i përditshëm sipas përshkrimit të detyrave nga neni 1 i kësaj kontrate është **tre Jave (15 dite kalendarik)**.

2.2 Vendi i kryerjes së puneve sipas Projektit ne AMF Drenovc dhe Shtupel :

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të puneve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 1.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kryesit të punimeve sipas kontratës publike.

3.3 Çmimet e njërive do të jenë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike .

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

3.5.Dhe ate me fature dhe Raport mbi kryerje te puneve , Jo me larg se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3. Pagesat do te ekzekutohen me keste sipas dinamike se kryerjeve te punimeve

Pagesat do te behen sipas situacineve mbi kryerje te punimeve me Raport nga Komisioni dhe Fatura.Jo me teper se 30 dite pas pranimit te fatures dhe Raportit .

- **Pas Pageses finale do te kerkohet Garancioni , Garancionit te punimeve , perkatesisht ne afat prej 12 muajeve .**

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *puneve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

6.2. Kryesi i puneve do te jete pergjegjes per Demtimet te shkaktuara me dashje apo pa kujdesi ne masen e demit qe do te percaktohet nga zyrtari pergjegjes .

Neni 7 Vonesat në ekzekutim

7.1 Ne raste deshtimit apo voneses ne Implementim , Do te penalizohet me masen 0.25% ne dite vonese nga vlera totale e kontrates.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

8.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, dhe të shikoj furnizimet e bera nese eshte ne masen e cilesive te kerkuara .

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

10.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 5 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

11.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

11.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore _dega Kline në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 12 Komunikimi

12.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë

12.2 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në

formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


Neni 6. Menaxhimi i projektit dhe menaxhimi i kontrates .

6.1. Menxhimi i projektit do te behet nga njesia kerkuese –Implementuese Drejtoria Urbanizmit Komuna Kline

6.2 .Menxhimi i Kontrates . Bazuar ne neni 81 te LPP , Menaxhi i kontrtaes me vendim te ZKA do te jete : _____ nga _____

6.3 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në kater origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues
KOMUNA KLINE**

Emri:	ABAZ FONIQI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.08.2020
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve :

LIMIT L ^B- SHPK – PRIZREN

Emri:	LIRIJEN ASLLANI
Pozita:	PRONAR - / autorizon
Nënshkrimi:	
Data:	27.08.2020
Vula:	

PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

- 1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.
- 1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.
- 1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.
- 1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shumën e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.
- 1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.
- 1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin e Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.
- 1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që bën Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.
- 1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

- 2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.
- 2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

- 3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.
- 3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:
- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
 - b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.
- 3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.
- 3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

- 4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një palë të tretë.
- 4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshme.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihë lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënien të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2 Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objekteve ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3 Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbushë detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmëroj palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasat ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdorur është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo injeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës; (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës; (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston e kra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërke me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i pafektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrat.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktojë "Menaxherin e Projektit", i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- të ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar në emër të disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me një operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteleve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur që të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike komizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga reziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i lillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me nonnë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteleve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike komizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është– <u>DREJTORIA E SHENDETESISE – BARTES I PROJEKTIT</u> <u>MENXHER I KONTRATES ESHTË</u> <u>NGA</u> <u>Drejtoria</u>
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është: 10 % vlerës së kontratës, PERKATESISHTË VLERA 1.447,47. € ME AFATE 15+30=45 dite kalendarik
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës b) Përgjegjësia e pales së tretë 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës d) Përgjegjësia profesionale 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve 100 % përgjegjesi e Operatorit Ekonomit fitues të kontratës
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është gja tere kohes se Validitetit te Kontrates.
Afati i Implementimit	17.2	Plani i plementimit te projektit 15 dite pune .
Mos realizimii apo sanksionet	17.3	Per cdo dite vonese do te sanksionohet 0.25% ng vlere e kontrates per dite vonese.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Do te përpiqet qe me pajtueshmëri te dy paleve te zgjidhen problemet .
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>Gjykata Themelore Peje – Dega Kline</u> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	NPTSH "LIMIT L&b" SHPK
Adresa	Xheladin Hana nr 20
Qyteti	Prizren
Kodi Postar	20000
Kontakti	Liman Asllani
Telefoni	049502505
Rak	029 242213
E-mail	Info&limitlb
Numri i TVSH	330075863

BANKA	
Emri	Raiffeisen Bank
Adresa	Prizren
Qyteti	Prizren
Kodi Postar	
Shërb	20000
Llogaria Bankare	1502001000467970
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
Ministry of Trade and Industry

ARBK

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TE BIZNESIT NE KOSOVE
KOSOVSKA AGENCIJA ZA REGISTRACIJE BIZNISA
KOSOVA BUSINESS REGISTRATION AGENCY

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
CERTIFICATE OF REGISTRATION

810593617

Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

. Limit L & B SH.P.K.

Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

///

Emri tregtar / Trgovačko ime / Commercial name

Lloji biznesit:
Poslovni tip:
Business type:

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Društva sa ograničenom odgovornošću
Limited Liabilities Companies

Adresa:
Adresa:
Address:

Nr.20, Xheladin Hana
Prizren

Data e regjistrimit:
Datum registracije:
Date of registration:

30/12/2003

27/02/2019

Data / Date / Datum




Nënshkrimi / Signature / Potpis



N.P.T.S.H.
Limit
Sh.p.k.



Rr.Xheladin Hana nr.20
20000 Prizren,Kosovë
Tel&Fax.: 029 242 213
Mob. 044 502 505 / 044 113 371
e-mail: info@limitlb.com
web: www.limitlb.com

per

KOMUNE E KLINE
ZYRA E PROKURIMIT


LENDA: Plani Dinamik
RENOVIME LOT 2- RENOVIM I AMF NE DRENOVC DHE SHTUPEL

PUNËT	Java I	Java II	Java III
RENOVIME LOT 2- RENOVIM I AMF NE DRENOVC DHE SHTUPEL	XXXX	XXX	XXX

20.07.2020

Drejtori: Liman Asllani





N.P.T.S.H.
Limit
Sh.p.k.



Rr.Xheladin Hana nr.20
20000 Prizren,Kosovë
Tel&Fax.: 029 242 213
Mob. 044 502 505 / 044 113 371
e-mail: info@limitb.com
web: www.limitb.com

Drejtori Ndërmarrjes, Liman Asllani, ecc i dipl., merr

V E N D I M

emron Haxhi Shehun inxhinjer te diplomuar te ndertimtarise, për projekt menaxher në punët e dosjen se tenderit me nr.pr. 634-20-047-521 DHE Titulli: RENOVIME LOT 1- RENOVIME NE QKMF , NE SALL TE KONFERENCAVE -ZHVP DHE NE MJEKESI FAMILAJARE DHE SPECIALISTIK , LOT 2- RENOVIM I AMF NE DRENOVC DHE SHTUPEL.

Prizren, 15.07.2020



Drejtori: Liman Asllani



27.08.2020,Prizren

“Limit L&B” sh.p.k. me numër unik identifikues 810593617 , me seli në rrugën Xheladin Hana nr.20 në Prizren ,e që përfaqësohet nga Liman Asllani , i lindur me 22.12.1958 , me numër personal 1006442893 lëshon këtë :

Autorizim

Me të cilin autorizohet Liburn Asllani , i lindur me 20.12.1985 në Prizren , me numër personal 1171503228 , që të nënshkruaj kontratën “**Renovime LOT 2 - RENOVIM I AMF NE DRENOVC DHE SHTUPEL** me nr. **634-20-3225-5-2-1**” pranë Zyres së Prokurimit të Komunës së Klinës .

Autorizimi vlen vetëm për arsyet e lartë përmendura.

N.P.T.SH. “Limit L&B” sh.p.k.
Drejtori

Liman Asllani





Garanci Ekzekutimi



Serial 070030060012958

Për **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

"LIMIT L&B" SH.P.K.

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marre përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

RENOVIME LOT 2- RENOVIM I AMF NE DRENOVC DHE SHTUPEL

të dhënë me numrin e Prokurimit: **634-20-3225-521/634-20-047-521**

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit të specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

€ 1,447.47

Nje mije dhe Kater qinde dhe Katerdhjete dhe Shtate presje Kater qinde dhe Shtatedhjete €

(shuma e garancisë në shifra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

€ 1,447.47

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen

(shuma e garancisë)

arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

28.08.2020

deri më

11.10.2020

Lëshuar në

Dega Prizren

datë

27.08.2020

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Agjenti: **Pranvera Shehu**



PLANI PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS

Sipas Nenit 81.2 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042

Data e përgatitjes së PMK¹ 27.08.2020

Përgatitur nga: **vendos emrin dhe mbiemrin e Menaxherit të Projektit të AK-**
-DREJTOR I DREJTORISE KOMUNALE E SHENEDETESISSE DHE MIREQENJES SOCIALE

Numri i Prokurimit	634-20-3225-521		
Titulli i Kontratës	<u>RENOVIMI I AMF NE DRENOC DH SHTUPEL</u>		
Punë/Shërbime/Furnizime	Viti Buxhetor	Emri dhe mbiemri i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	
PUNE	2020	ABAZ FONIQI	

Ngjarjet/Rezultatet e Kontratës	DETAJET E IMPLEMENTIMIT Afatet 15 DITE PUNE VLERA 14.474.71 €
Pjesët nën 'Detajet e Implementimit' në <i>italike</i> duhet të kompletohen dhe të bien dakord në mesë të palëve të kontratës para inicimit të implementimit të kontratës. PMK duhet të përtërihet gjatë implementimit të kontratës. Vendos Nuk Aplikohet për ato që nuk janë relevante	
I. Fillimi/ Mobilizimi i Kontratës	
Njoftimi për fillimin e punës/shërbimeve/furnizimit të mallrave	ME DATE 01.09.2020
Afati i përmbushjes	<u>PLANI IMPLAEMENTIMIT -25 DITE PUNE</u>
Pranimi i garancisë së performancës dhe lirimi i sigurimit të tenderit	PO SIGURIMI I KONTRATES NE VLERE 1.447.47 EURO ME VALIDITET 15 +30=45 DITE

¹ Plan i Menaxhimit të Kontratës është dokument i gjallë i cili do të përtërihet bazuar në mbikëqyrjen e punëve, shërbimeve apo mallrave në pajtim me kushtet e parashtruara në kontratën origjinale. Plan i Menaxhimit të Kontratës është i hapur për monitorim të KRPP-së gjatë implementimit të kontratës dhe të gjitha auditimeve tjera të kryera nga organet shtetërore. PMK duhet të përdoret së bashku me rregullat e miratuara për menaxhimin e aktiviteteve të kontratës, të nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Pranimi i garancisë së pagesës në avans, nëse është e aplikueshme	SKA AVANS
Pagesa e avansit , nëse është e aplikueshme	SKA
Dorëzimet e para Shërbimet: raporti fillestarë Punët: instalimi i parë	
Shuma e dëmeve të likuiduara përfshirë kufizimin e dëmeve të likuiduara	
Periudha e përgjegjësisë për defekte	
II. Progresi i Kontratës	
Dorëzimet e Mëtutjeshme Shërbimet: raportet e progresit etj. Punët: instalimi i dytë etj.	
Bisedimet e Rregullta, nëse është e aplikueshme	
Inspektimi i punëtorive, materialeve dhe vendeve të prodhimit	
Pagesat e përkohshme apo në faza, nëse është e aplikueshme	
Reduktimi i garancive, nëse është e aplikueshme	Ska avans
III. Përmbyllja e Kontratës	
Dorëzimet Finale Shërbimet: Raporti Final Punët: Përfundimi i Punëve	
Pranimi/ dorëzimi	
Pagesa e Fundit	
Fondet e mbajtura	
Skadimi i garancionit/periudha e përgjegjësisë	
Lirimi i garancisë	

Finalizimi i Planit të Menaxhimit të Kontratës²:

Në emër të Autoritetit Kontraktues ; KK KLINE –DREJTORIA KOMUNALE E SHENDETESISE

Nënshkrimi: _____

Emri: ANTON SHLLAKU

Pozita: DREJTOR

Data: _____

Në emër të [Kontraktuesit/Ofruesit të Shërbimeve – LIMIT L & B- SHPK - PRIZREN

Emri: SUADA ASLLANI

Nënshkrimi:

Data: _____

Pozita: _____

NGA A.K.

DORUNTINA DUSHI

MENAXHER I KONTRATE NGA O.E, LIBURN ASLLANI

² Të nënshkruhet nga dy Menaxherët e Projektit